



KËSHILLI I QARKUT TIRANË  
Sektori i Shërbimeve dhe Burimeve Njerëzore

**SHPALLJE PËR LËVIZJE PARALELE  
PRANIM NË SHËRBIMIN CIVIL  
NË KATEGORINË EKZEKUTIVE  
Specialist**

**Specialist për Marrëdhëniet Ndërinstitucionale dhe Publike në Këshillin e Qarkut Tiranë**

**Lloji i diplomës "Shkenca shoqërore dhe të komunikimit". Niveli diplomës "Master Shkencor"**

Në zbatim të nenit 22 dhe të nenit 25, të ligjit 152/2013 "Për nëpunësin civil" (i ndryshuar), si dhe të Kreut II, IV dhe VII, të Vendimit nr. 243, datë 18/03/2015, të Këshillit të Ministrave, Këshilli i Qarkut Tiranë shpall procedurat e lëvizjes paralele dhe të pranimit në shërbimin civil për kategorinë ekzekutive për pozicionin:

- **1 (një) Specialist për Marrëdhëniet Ndërinstitucionale dhe Publike, në Drejtorinë e Koordinimit Zhvillimit kategoria IV-a**

*Pozicioni më sipër, u ofrohet fillimisht nëpunësve civilë të së njëjtës kategori për procedurën e lëvizjes paralele! Vetëm në rast se nga ky pozicion, në përfundim të procedurës së lëvizjes paralele, rezulton se ende ka pozicion vakant, janë të vlefshme për konkurimin nëpërmjet procedurës së pranimit në shërbimin civil për kategorinë ekzekutive.*

**Për të dy procedurat (lëvizje paralele, pranim në shërbimin civil në kategorinë ekzekutive) aplikohet në të njëjtën kohë!**

**Afati për dorëzimin e dokumentave për:**

**LËVIZJE PARALELE:**

**6 maj 2016**

**Afati për dorëzimin e dokumentave për:**

**PRANIM NË SHËRBIM CIVIL:**

**11 maj 2016**

## Përshkrimi përgjithësues i punës për pozicionin si më sipër është:

Mbajtjen e marrëdhënieve të Këshillit të Qarkut, Kryetarit dhe administratës së tij me publikun. Ndjekjen në vazhdimësi të problemeve, që ngrihen në mjetet e përditshme të informimit publik në lidhje me fushën e veprimit të institucionit të Këshillit të Qarkut si dhe informimin me shkrim mbi problematikat e evidentuara. Organizimin e njoftimeve, informacioneve dhe konferencave për shtyp në lidhje me veprimtarinë e institucionit dhe Kryetarit. Mbajtjen e një regjistri të veçantë për kërkesat, që vijnë në institucion, duke evidentuar të dhënat që lidhen me ankimin, njoftimin dhe konsultimin publik dhe të drejtën për informim të qytetarëve. Ndjekjen e procedurave për realizimin e koordinimit të funksioneve të Këshillit të Qarkut me organet e vetëqeverisjes vendore të nivelit të parë dhe institucionet e tjera me të cilat lidhet zbatimi i veprimtarisë së institucionit. Kujdesjen për përditësimin e informacionit në faqen zyrtare të internetit të institucionit me njoftimet dhe veprimtaritë përkatëse të realizuara. Administrimin e veprimtarisë për garantimin e të drejtës së informimit, menaxhimin e procedurave për njoftimin e konsultimin publik të projekt-akteve me format përkatëse të përcaktuara për këtë qëllim. Hartimin dhe propozimin e aspekteve të strategjisë dhe politikave për marrëdhëniet publike dhe mediatike të institucionit dhe kryetarit. Hartimin e deklaratave, njoftimeve e komunikimit në përgjithësi të veprimtarive të institucionit dhe titullarit, në bashkëpunim me punonjësit përkatës.

## 1 LËVIZJAPARALELE

Kanë të drejtë të aplikojnë për këtë procedurë vetëm nëpunësit civilë të së njëjtës kategori, në të gjitha institucionet pjesë e shërbimitcivil.

### 1.1 KUSHTET PËR LËVIZJEN PARALELE DHE KRITERET EVEÇANTA

**Kandidatët duhet të plotësojnë kushtet për lëvizjen paralele sivijon:**

- a- Të jenë nëpunës civil i konfirmuar, brenda së njëjtëskategori;
- b- Të mos kenë masë disiplinore nëfuqi;
- c- Të kenë të paktën vlerësimin e fundit “mirë” apo “shumëmirë”;

**Kandidatët duhet të plotësojnë kriteret e posaçme sivijon:**

- a- Të zotërojnë një diplomë të nivelit “Master Shkencor” në fushën e shkencave shoqërore dhe të komunikimit, dhe diploma e nivelit “Bachelor” duhet të jetë në të njëjtënfushë(*diplomat të cilat e marra jashtë Republikës së Shqipërisë të përcillet njehësimi nga Ministria e Arsimit dhe e Sportit*);
- b- Të kenë eksperiencë pune jo më pak se 3 vjet në fushën e komunikimit publik dhe medias;
- c- Të njohin dhe të përdorin programet bazë të punës në kompjuter (word, excel, internet);
- d- Të zotërojnënjë gjuhë të huaj.
- e- Preferohen përvoja dhe kontakte në fushën e medias dhe shtypit të përditshëm, aftësi për të ofruar informacion të saktë dhe në kohë reale, për të koordinuar, kontrolluar dhe vlerësuar përdorimin e informacioneve; aftësi organizimi komunikimi dhe prezantimi.

## 1.2 DOKUMENTACIONI, MËNYRA DHE AFATI I DORËZIMIT.

---

### Kandidatët që aplikojnë duhet të dorëzojnë dokumentat si më poshtë:

- a- Jetëshkrim i plotësuar në përputhje me dokumentin tip që e gjeni në linkun: <http://dap.gov.al/legjislacioni/udhezime-manuale/60-jeteshkrim-standard>.
- b- Fotokopje të diplomës (përfshirë edhe diplomënbachelor). Për diplomat e marra jashtë Republikës së Shqipërisë të përcillet njehsimi nga Ministria e Arsimit dhe e Sportit;
- c- Fotokopje të librezës së punës (të gjitha faqet që vërtetojnë eksperiencën nëpunë); d- Fotokopje të letërnjoftimit(ID);
- e- Vërtetim të gjendjes shëndetësore;
- f- Vetëdeklarim të gjendjesgjyqësore;
- g- Vlerësimin e fundit nga eproridirekt;
- h- Vërtetim nga Institucioni që nuk ka masë disiplinore nëfuqi;
- i- Çdo dokumentacion tjetër që vërteton trajnimet, kualifikimet, arsimim shtesë,vlerësimet pozitive apo të tjera të përmendura në jetëshkrimintuaj;

**Dorëzimi i dokumentave për levizjen paralele duhet** të bëhet me postë ose drejtpërsëdrejti në institucion (Sektori Shërbimeve dhe Burimeve Njerëzore – Këshilli i Qarkut Tiranë/ Sheshi “Mustafa Kemal Atatürk” Tiranë), brenda datës **06.05.2016**.

## 1.3 REZULTATET PËR FAZËN E VERIFIKIMITPARAPRAK

---

Në datën **09.05.2016**Sektorii Shërbimeve dhe Burimeve Njerëzore në Këshillin e Qarkut Tiranë do të shpallë në portalin “Shërbimi Kombëtar i Punësimit” dhe në faqen zyrtare të internetit listën e kandidatëve që plotësojnë kushtet dhe kriteret e veçanta të lëvizjes paralele si dhe datën, vendin dhe orën e saktë ku do të zhvillohet intervista.

Në të njëjtën datë kandidatët që nuk i plotësojnë kushtet dhe kriteret e veçanta të procedurës së lëvizjes paralele do të njoftohen individualisht nga Sektori i Shërbimeve dhe Burimeve Njerëzore në Këshillin të Qarkut Tiranë, në mënyrë elektronike, për shkaqet e moskualifikimit (*nëpërmjet adresës së e-mail*).

## 1.4

### FUSHAT E NJOHURIVE, AFTËSITË DHE CILËSITË MBI TË CILAT DO TË ZHVILLOHET INTERVISTA

---

#### Kandidatët do të vlerësohen në lidhje me:

- a- Njohuritë mbi Ligjin Nr.152/2013, “Për nëpunësin civil”, (i ndryshuar) si dhe aktet nëligjore dalë në zbatim të tij;
- b- Njohuritë mbi Ligjin Nr.9131, datë 08.09.2003, “Për rregullat e etikës në administratën publike”;
- c- Njohuritë mbi Ligjin Nr.44/2015, datë 30.04.2015, “Kodi i Proçedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë”;
- d- Njohuritë mbi Ligjin Nr.119/2014 datë 18.09.2014 “Për të drejtën e informimit”;
- e- Njohuritë mbi Ligjin Nr.139/2015, datë 17.12.2015 “Për vetëqeverisjen vendore”;
- f- Njohuritë mbi Ligjin Nr.9887, datë 10.03.2008 “Për mbrojtjen e të dhënave personale” (i ndryshuar);
- g- Njohuritë mbi Ligjin Nr.146/2014 datë 30.10.2014 “Për njoftimin dhe konsultimin publik”.

## 1.5

### MËNYRA E VLERËSIMIT TË KANDIDATËVE

---

#### Kandidatët do të vlerësohen në lidhje me dokumentacionin edorëzuar:

Kandidatët do të vlerësohen për përvojën, trajnimet apo kualifikimet e lidhura me fushën, si dhe certifikimin pozitiv ose për vlerësimet e rezultateve individuale në punë në rastet kur procesi i certifikimit nuk është kryer. Totali i pikëve për këtë vlerësim është **40pikë**.

#### Kandidatët gjatë intervistës së strukturuar me gojë do të vlerësohen në lidhje me:

- a- Njohuritë, aftësitë, kompetencën në lidhje me përshkrimin e pozicionit të punës;
- b- Eksperiencën e tyre të mëparshme;
- c- Motivimin, aspiratat dhe pritshmëritë e tyre për karrierën;

Totali i pikëve për këtë vlerësim është **60pikë**.

Më shumë detaje në lidhje me vlerësimin me pikë, metodologjinë e shpërndarjes së pikëve, mënyrën e llogaritjes së rezultatit përfundimtar i gjeni në Udhëzimin nr.2, datë 27.03.2015, të Departamentit të Administratës Publike [www.dap.gov.al](http://www.dap.gov.al).

Në përfundim të vlerësimit të kandidatëve, Sektori i Shërbimeve dhe Burimeve Njerëzore në Këshillin e Qarkut Tiranë do të shpallë fituesin në portalin “Shërbimi Kombëtar i Punësimit” dhe faqen zyrtare të internetit. Të gjithë kandidatët pjesëmarrës në këtë procedurë do të njoftohen individualisht në mënyrë elektronike nga Sektori i Shërbimeve dhe Burimeve Njerëzore, për rezultatet (*nëpërmjet adresës së e-mail*).

## 2 PRANIMI NË SHËRBIMIN CIVIL

---

*Vetëm në rast se nga pozicioni i renditur në fillim të kësaj shpalljeje, në përfundim të procedurës së lëvizjes paralele, rezultojnë ende ka pozicion vakant, ky pozicion është i vlefshëm për konkurimin nëpërmjet procedurës së pranimit në shërbimin civil për kategorinë ekzekutive. Këtë informacion do ta merrni në “Portalin Shërbimi Kombëtar i Punësimit” në faqen e internetit të Këshillit të Qarkut Tiranë, duke filluar nga data 21.05.2016.*

### 2.1 KUSHTET QË DUHET TË PLOTËSOJË KANDIDATI NË PROCEDURËN E PRANIMIT NË SHËRBIMIN CIVIL DHE KRITERET EVEÇANTA

---

Për këtë procedurë kanë të drejtë të aplikojnë të gjithë kandidatët jashtë sistemit të shërbimit civil, që plotësojnë kërkesat e përgjithshme sipas nenit 21, të Ligjit Nr.152/2013 “Për nëpunësin civil” (*i ndryshuar*).

**Kushtet që duhet të plotësojë kandidati në procedurën e pranimit në shërbimin civil janë:**

- a- Të jetë shtetashqiptar;
- b- Të ketë zotësi të plotë për të vepruar;
- c- Të zotërojë gjuhën shqipe, të shkruar dhe të folur;
- d- Të jetë në kushte shëndetësore që e lejojnë të kryejë detyrën përkatëse;
- e- Të mos jetë idënuar me vendim të formës së prerë për kryerjen e një krimi apo për kryerjen e një kundërvajtjeje penale medashje;
- f- Ndaj tij të mos jetë marrë masa disiplinore e largimit nga shërbimi civil, që nuk është shuar sipas Ligjit Nr.152/2013 “Për nëpunësin civil” (*indryshuar*).

**Kandidatët duhet të plotësojnë kriteret e posaçme sivejton:**

- a- Të zotërojnë një diplomë të nivelit “Master Shkencor” në fushën e shkencave shoqërore dhe të komunikimit, dhe diploma e nivelit “Bachelor” duhet të jetë në të njëjtën fushë (*diplomat të cilat e marra jashtë Republikës së Shqipërisë të përcillet njuhësimi nga Ministria e Arsimit dhe e Sportit*);
- b- Të kenë eksperiencë pune jo më pak se 3 vjet në fushën e komunikimit publik dhe medias;
- c- Të njohin dhe të përdorin programet bazë të punës në kompjuter (word, excel, internet);
- d- Të zotërojnë gjuhë të huaja;
- e- Preferohen përvoja dhe kontakte në fushën e medias dhe shtypit të përditshëm, aftësi për të ofruar informacion të saktë dhe në kohë reale, për të koordinuar, kontrolluar dhe vlerësuar përdorimin e informacioneve; aftësi organizimi komunikimi dhe prezantimi.

## **2.2 DOKUMENTACIONI, MËNYRA DHE AFATI I DORËZIMIT**

### **Kandidatët që aplikojnë duhet të dorëzojnë dokumentat si mëposhtë:**

- a- Jetëshkrim i plotësuar në përputhje me dokumentin tip që e gjeni në linkun:  
<http://dap.gov.al/legjislacioni/udhezime-manuale/60-jeteshkrim-standard>.
- b- Fotokopje të diplomës (përfshirë edhe diplomënbachelor).(*për diplomat të cilat e marra jashtë Republikës së Shqipërisë të përcillet njuhësimi nga Ministria e Arsimit dhe e Sportit*);
- c- Fotokopje të librezës së punës (të gjitha faqet që vërtetojnë eksperiencën nëpunë); d- Fotokopje të letërnjoftimit(ID);
- e- Vërtetim të gjendjes shëndetësore;
- f- Vetëdeklarim të gjendjesgjyqësore;
- g- Çdo dokumentacion tjetër që vërteton trajnimet, kualifikimet, arsimim shtesë, vlerësimet pozitive apo të tjera të përmendura në jetëshkrimintuaj.

**Dorëzimi i dokumentave për pranimin në shërbimin civil duhet të behet me postë ose drejtpërsëdrejti në institucion (Sektori i Shërbimeve dhe Burimeve Njerëzore – Këshilli i Qarkut Tiranë/ Sheshi “Mustafa Kemal Atatürk” Tiranë), brenda datës **11.05.2016**.**

## **2.3 REZULTATET PËR FAZËN E VERIFIKIMIT PARAPRAK**

Duke filluar nga data **21.05.2016**, Sektorii Shërbimeve dhe Burimeve Njerëzore në Këshillin e Qarkut Tiranë do të shpallë në portalin “Shërbimi Kombëtar i Punësimit” dhe në faqen zyrtare të internetit listën e kandidatëve që plotësojnë kushtet dhe kriteret e veçanta për procedurën e pranimit në shërbimin civil, si dhe datën, vendin dhe orën e saktë ku do të zhvillohet testimi me shkrim dhe intervista.

Në të njëjtën datë kandidatët që nuk i plotësojnë kushtet dhe kriteret e veçanta për procedurën e pranimit në shërbimin civil do të njoftohen individualisht në mënyrë elektronike nga Sektorii i Shërbimeve dhe Burimeve Njerëzore të Këshillit të Qarkut Tiranë, për shkaqet e moskualifikimit (*nëpërmjet adresës së e-mail*).

**Kandidatët do të testohen me shkrim në lidhje me:**

- a- Njohuritë mbi Ligjin Nr.152/2013, “Për nëpunësin civil” (i ndryshuar) si dhe aktet nëligjore dalë në zbatim të tij;
- b- Njohuritë mbi Ligjin Nr. 9131, datë 08.09.2003, “Për rregullat e etikës në administratën publike”;
- c- Njohuritë mbi Ligjin Nr. 44/2015, datë 30.04.2015, “Kodi i Proçedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë”;
- d- Njohuritë mbi Ligjin Nr.119/2014 datë 18.09.2014 “Për të drejtën e informimit”;
- e- Njohuritë mbi Ligjin Nr.139/2015, datë17.12.2015 “Për vetëqeverisjen vendore”;
- f- Njohuritë mbi Ligjin Nr.9887, datë 10.03.2008 “Për mbrojtjen e të dhënave personale” (i ndryshuar);
- g- Njohuritë mbi Ligjin Nr.146/2014 datë 30.10.2014 “Për njoftimin dhe konsultimin publik”.

**Kandidatët gjatë intervistës së strukturuar me gojë do të vlerësohen në lidhje me:**

- a- Njohuritë, aftësitë, kompetencën në lidhje me përshkrimin përgjithësues të punës për pozicionet;
- b- Eksperiencën e tyre të mëparshme;
- c- Motivimin, aspiratat dhe pritshmëritë e tyre për karrierën;

**2.5 MËNYRA E VLERËSIMIT TË KANDIDATËVE**

---

**Kandidatët do të vlerësohen në lidhje me:**

- a- Vlerësimin me shkrim, deri në **60 pikë**;
- b- Intervistën e strukturuar me gojë që konsiston në motivimin, aspiratat dhe pritshmëritë etyre për karrierën, deri në **25 pikë**;
- c- Jetëshkrimin, që konsiston në vlerësimin e arsimit, të përvojës të trajnimeve, të lidhur me fushën, deri në **15 pikë**;

Më shumë detaje në lidhje me vlerësimin me pikë, metodologjinë e shpërndarjes së pikëve, mënyrën e llogaritjes së rezultatit përfundimtar i gjeni në Udhëzimin nr.2, datë 27.03.2015, të Departamentit të Administratës Publike [www.dap.gov.al](http://www.dap.gov.al).

## **2.6 DATA E DALJES SË REZULTATEVE TË KONKURIMIT DHE MËNYRA EKOMUNIKIMIT**

---

Në përfundim të vlerësimit të kandidatëve, Sektori i Shërbimeve dhe Burimeve Njerëzore në Këshillin e Qarkut Tiranë do të shpallë fituesin në portalin “Shërbimi Kombëtar i Punësimit” dhe faqen zyrtare të internetit. Të gjithë kandidatët pjesëmarrës në këtë procedurë do të njoftohen individualisht në mënyrë elektronike nga Sektori i Shërbimeve dhe Burimeve Njerëzore, për rezultatet (nëpërmjet adresës së e-mail).

Të gjithë kandidatët që aplikojnë për procedurën e pranimit në shërbimin civil për kategorinë ekzekutive, do të marrin informacion në faqen zyrtare të internetit të Këshillit të Qarkut Tirane si dhe numër telefoni në 042225141 ose në adresën: Keshilli i Qarkut Tirane “Sheshi Mustafa Kemal Atatürk”, për fazat e mëtejshme të procedurës së pranimit në shërbimin civil të kategorisë ekzekutive:

- për datën e daljes së rezultateve të verifikimit paraprak;
- datën, vendin dhe orën ku do të zhvillohet konkurimi,

Për të marrë këtë informacion, kandidatët duhet të vizitojnë në mënyrë të vazhdueshme faqen zyrtare të internetit të Këshillit të Qarkut Tiranë duke filluar nga data 21.05.2016 si dhe numër telefoni në 042225141 ose në adresën: Keshilli i Qarkut Tirane “Sheshi Mustafa Kemal Atatürk”.

Sektori i Shërbimeve dhe Burimeve Njerëzore

**Matilda Hamzallari**



